

# PERCEPTIMI PUBLIK NDAJ INSTITUCIONEVE TË SIGURISË DHE DREJTËSISË, SI DHE ÇËSHTJEVE TË KORRUPSIONIT NË SHQIPËRI



### Autorë:

Mirsada Hallunaj dhe Nino Strati

### Metodologjia dhe koordinimi i punës në terren:

Eduard Zaloshnja

### Recensimi i brendshëm:

Arjan Dymishi

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: [info@qkss.org](mailto:info@qkss.org) ose +383 38 221 420.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë nga anketa e Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP). BSBP është një nismë e re rajonale e iniciuar nga QKSS në vitin 2020, e cila zbatohet në bashkëpunim me Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) në Serbi dhe Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në Shqipëri, me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). BSBP shërben si një instrument për të matur perceptimet e publikut në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi për çështje të ndryshme lidhur me sigurinë. Të dhënat tregojnë se si qytetarët i perceptojnë apo informohen rreth çështjeve të paraqitura në këtë raport. Si të tilla, pikëpamjet e paraqitura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e QKSS, BCSP, CSDG ose NED.

**Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën Angleze.**

Financohet nga :



Konsorciumi i drejtuar nga:



# **PERCEPTIMI PUBLIK NDAJ INSTITUCIONEVE TË SIGURISË DHE DREJTËSISË, SI DHE ÇËSHTJEVE TË KORRUPSIONIT NË SHQIPËRI**

# PËRMBAJTJA

1. Hyrje .....	1
2. Perceptimi publik ndaj institucioneve të sigurisë .....	2
3. Perceptimi publik ndaj institucioneve të drejtësisë.....	7
4. Perceptimi publik ndaj çështjeve të korrupsionit .....	11
5. Përmbyllja .....	14

# 1. HYRJA

Barometri i Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP) është një projekt rajonal i zbatuar nga organizata lokale të shoqërisë civile, i cili mat perceptimet e publikut në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi për një gamë të gjerë çështjesh të ndryshme të lidhura me sigurinë, sundimin e ligjit, drejtësinë, bashkëpunimin rajonal dhe çështje që lidhen me ndërtimin e paqes.

BSBP ka një metodologji identike në të tri vendet, duke matur njëkohësisht perceptimet e qytetarëve të Kosovës dhe Serbisë për të njëjtat çështje. Rezultatet e BSBP do të publikohen në katër raporte të ndryshme për secilin vend.

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) i është bashkuar Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP) për të dytin vit radhazi që nga viti 2021. Së bashku me Barometrin Kombëtar të Sigurisë që Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) ka prodhuar që nga viti 2019, ky projekt ka prodhuar një mori të dhënash, të cilat janë përdorur nga një gamë e gjerë aktorësh përfshirë politikëbërësit, ekspertët e sigurisë, akademia, mediat, donatorët ndërkombëtarë, etj.

Edicioni rajonal mat jo vetëm perceptimin e qytetarëve shqiptarë ndaj institucioneve të tyre dhe çështjeve të sigurisë, por edhe perceptimet e tyre ndaj bashkëpunimit rajonal dhe konkretisht marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë, Kosovës dhe Serbisë. Raporti i parë ishte "Perceptimi ndaj sigurisë publike, kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme ndaj sigurisë në Shqipëri" (2022). Ky është raporti i dytë "Perceptimi publik ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë, si dhe çështjeve të korrupsionit në Shqipëri" 2022, i cili paraqet vetëm rezultatet për Shqipërinë

Raporti është prodhuar në bazë të të dhënave të mbledhura nga një anketë e bazuar në kampion rastësor të shtresëzuar prej 1120 personash në moshë madhore kryer gjatë periudhës 23 shtator-2 tetor 2022 përmes intervistave ballë për ballë.

Anketat u shpërndanë proporcionalisht në 61 bashki të Shqipërisë, duke marrë parasysh zonat rurale/urbane, gjininë dhe kuotat e moshës. Bazuar në këtë qasje të shtresëzuar kampionimi është arritur një përfaqësim i saktë gjeografik dhe demografik i popullsisë së rritur të Shqipërisë, duke ruajtur një marzh gabimi më të ulët se  $\pm 2,9\%$  për kampionin e përgjithshëm.

## 2. PERCEPTIMI PUBLIK NDAJ INSTITUCIONEVE TË SIGURISË

Ky kapitull paraqet rezultatet e anketës që kanë të bëjnë me opinionin e qytetarëve ndaj institucioneve të sigurisë. Institucionet e sigurisë të cilave u referohet ky raport përfshijnë Forcat e Armatosura, Policinë e Shtetit, Agjencinë Mbikëqyrjes Policore, Shërbimin Informativ të Shtetit, Policinë e Burgjeve, Administratën Doganore dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Ky kapitull përfshin gjithashtu opinionet e qytetarëve mbi institucione të tjera, të cilat kryejnë një rol mbikqyrës ndaj institucioneve të sigurisë, përkatësisht Kuvendi, Qeveria, Presidenti, Administrata Lokale dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Forcat e Armatosura mbeten institucioni më i besuar i sigurisë në Shqipëri, megjithëse më pak qytetarë nga viti i kaluar 2021 (32.99%) i besojnë ose besojnë plotësisht Forcave të Armatosura. Nuk ka dallime domethënëse midis kategorive të nën-kampionit që lidhen me moshën dhe arsimin.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile rezulton të jetë institucioni i dytë më i besuar (29.21%) sipas qytetarëve të pyetur në këtë sondazh.


Opinionin e qytetarëve ndryshon më shumë në lidhje me opinionin e tyre mbi Policinë e Shtetit. Vetëm 26.37% e të anketuarve i besojnë ose besojnë plotësisht Policisë së Shtetit, ndërsa 30.45% e të anketuarve i besojnë disi. Një pjesë e konsiderueshme e të pyeturve (43.06%) kanë pak ose aspak besim.

Administrata Doganore shikohet si institucioni më pak i besuar. Vetëm 14.84% e të anketuarve i besojnë ose besojnë plotësisht Administratës Doganore dhe 27,80% të tjerë kanë pak besim. Më shumë se gjysma e të pyeturve (53.01%) nuk i besojnë këtij institucioni.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore dhe Policia e Burgjeve gëzojnë nivele të ulta deri të moderuara besimi tek qytetarë. 20.90% i besojnë ose besojnë plotësisht Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ndërkohë që 28.50% i besojnë disi. Nga ana tjetër, 17.63% i besojnë ose besojnë plotësisht Policisë së Burgjeve, ndërkohë që 30.50% i besojnë disi.

**FIGURA 1 NIVELI I BESIMIT NË INSTITUCIONET E SIGURISË NË SHQIPËRI**


**SA U BESONI INSTITUCIONEVE TË MËPOSHTME TË SIGURISË?**



Në krahasim me sondazhin e vitit të mëparshëm 2021, ka një ulje të numrit të të anketuarve të cilët i besojnë ose besojnë plotësisht institucioneve të Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Administratës Doganore, ndërkohë që përqindja e të anketuarve të cilët kanë pak ose aspak besim tek institucionet e lartpërmendura është rritur. (shiko grafik nr. 2)

**FIGURA 2** NIVELI I BESIMIT NË INSTITUCIONET E SIGURISË NË SHQIPËRI NË VITET 2022 DHE 2021

**NIVELI I BESIMIT NË INSTITUCIONET E SIGURISË NË VITIN 2022 DHE 2021**





Niveli i besimit tek institucionet e mbikqyrjes mbetet gjithashtu në nivele të ulta. Kuvendi i Shqipërisë konsiderohet si institucioni më pak i besuar nga të anketuarit, ku vetëm 1 në 10 persona (10.91%) janë përgjigjur se i besojnë ose besojnë plotësisht këtij institucioni. Ndërkohë, 2 në 3 persona (66.11%) është përgjigjur se ka pak ose aspak besim tek ky institucion.

18.49% e të anketuarve i besojnë ose besojnë plotësisht Qeverisë, ndërkohë që 60.59% kanë pak ose aspak besim tek ky institucion. Nga të gjitha institucionet publike të përfshira në këtë sondazh, administrata lokale konsiderohet nga 21.14% e të anketuarve si më e besuara nga të gjitha institucionet e tjera, e ndjekur nga institucioni i Presidentit, i cili konsiderohet nga 20.88% e të anketuarve si institucioni më i besuar.

Megjithatë, më shumë se gjysma e të anketuarve (52.57%) kanë pak ose aspak besim tek administrata lokale dhe thuhetse gjysma e të pyeturve në këtë sondazh (46.63%) kanë pak ose aspak besim tek institucioni i Presidentit.

### FIGURA 3 NIVELI I BESIMIT NË INSTITUCIONET QË KANË LIDHJE ME SIGURINË NË SHQIPËRI

#### SA U BESONI INSTITUCIONEVE TË TJERA TË MËPOSHTME?

##### KUVENDI I SHQIPËRISË

Se di/ S'kam opinion	0.22%
Nuk u besoj fare	36.56%
Kam pak besim	29.55%
Disi	22.77%
U besoj	10.42%
U besoj plotësisht	0.49%



##### ADMINISTRATA LOKALE

Se di/ S'kam opinion	0.08%
Nuk u besoj fare	24.48%
Kam pak besim	28.09%
Disi	26.21%
U besoj	19.09%
U besoj plotësisht	2.05%



##### QEVERIA

Se di/ S'kam opinion	0.16%
Nuk u besoj fare	36.49%
Kam pak besim	24.10%
Disi	20.76%
U besoj	16.16%
U besoj plotësisht	2.33%



##### KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Se di/ S'kam opinion	5.55%
Nuk u besoj fare	21.95%
Kam pak besim	24.81%
Disi	29.18%
U besoj	17.06%
U besoj plotësisht	1.45%



##### PRESIDENTI


Se di/ S'kam opinion	8.23%
Nuk u besoj fare	27.04%
Kam pak besim	19.59%
Disi	24.26%
U besoj	18.46%
U besoj plotësisht	2.42%



Në krahasim me sondazhin e vitit të mëparshëm 2021 vetëm institucioni i Presidentit ka shënuar një rritje të qytetarëve, të cilët i besojnë ose besojnë plotësisht këtij institucioni. Në qershor 2022 Kuvendi i Shqipërisë zgjodhi Presidentin e ri të vendit. (shiko grafik nr. 4)

**FIGURA 4 NIVELI I BESIMIT TEK INSTITUCIONET QË KANË LIDHJE ME SIGURINË NË SHQIPËRI NË VITET 2022 DHE 2021**

**NIVELI I BESIMI TEK INSTITUCIONET QË KANË LIDHJE ME SIGURINË NË VITIN 2022 DHE 2021**



### 3. PERCEPTIMI PUBLIK NDAJ INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË

Ky kapitull paraqet të gjitha rezultatet e anketës në lidhje me opinionin e qytetarëve ndaj institucioneve të drejtësisë në Shqipëri. Institucionet e drejtësisë të cilave u referohet ky raport përfshijnë gjykatat e qarqeve, prokuroritë e qarqeve, Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).

Ky kapitull paraqet gjithashtu edhe të dhëna në lidhje me besimin e publikut ndaj aktorëve joshpetërorë të tillë si orgaizatat jo-qeveritare (OJQ), media, komunitetet fetare dhe partitë politike.

Reforma në sistemin e drejtësisë në Shqipëri u konsiderua si një nga reformat më gjithëpërfshirëse të ndërmarra në vend gjatë dekadës së fundit. Kur në vitin 2016 kjo reform u miratua dhe filloi zbatimi, niveli i pritshmërive të qytetarëve ishte shumë i lartë. Pak më shumë se 6 vjet nga miratimi dhe zbatimi i Ndryshimeve Kushtetuese, pritshmëritë e publikut ndaj institucioneve të drejtësisë mbeten në nivele shumë të ulta.

SPAK konsiderohet si institucioni më i besueshëm bazuar në përgjigjet e qytetarëve. 26.30% e tyre i besojnë ose besojnë plotësisht këtij institucioni, ndërkohë që 25.31% i besojnë deri diku. Thuaqse gjysma e të anketuarve (45.38%) kanë pak ose aspak besim tek SPAK.

Në lidhje me gjykatat dhe prokuroritë e qarqeve, besimi i publikut ndaj këtyre institucioneve është më i ulët se besimi ndaj institucioneve të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Vetëm 13.08% e të anketuarve i besojnë ose besojnë plotësisht prokurorive të qarqeve dhe 13.47% i besojnë ose besojnë plotësisht gjykatave të qarqeve. Ndërkohë thuaqse gjysma e të anketuarve kanë pak ose aspak besim në prokuroritë dhe gjykatat e qarqeve.

**FIGURA 5 NIVELI I BESIMIT NË INSTITUCIONET E DREJTËSISË NË SHOIPËRI**

**SA U BESONI INSTITUCIONEVE TË MËPOSHTME TË DREJTËSISË?**

**GJYKATAT E QARQEVË**

- Se di/ S'kam opinion 2.79%
- Nuk u besoj fare 29.95%
- Kam pak besim 29.83%
- Disi 23.96%
- U besoj 12.11%
- U besoj plotësisht 1.36%



**PROKURORITË E QARQEVË**

- Se di/ S'kam opinion 2.71%
- Nuk u besoj fare 29.43%
- Kam pak besim 29.81%
- Disi 24.96%
- U besoj 12.07%
- U besoj plotësisht 1.01%



### 3. Perceptimi publik ndaj institucioneve të drejtësisë

#### GJYKATAT E POSAÇME

Se di/ S'kam opinion	3.12%
Nuk u besoj fare	19.12%
Kam pak besim	25.89%
Disi	27.27%
U besoj	21.63%
U besoj plotësisht	2.98%



#### PROKURORIA SPECIALE (SPAK)


Se di/ S'kam opinion	3.02%
Nuk u besoj fare	19.78%
Kam pak besim	25.60%
Disi	25.31%
U besoj	23.50%
U besoj plotësisht	2.80%




Ashtu sikurse me nivelin e besimit në institucionet e sigurisë, përqindja e të anketuarve të cilët i besojnë ose besojnë plotësisht gjykatave dhe prokurorive të qarqeve si edhe Gjykatave dhe Prokurorisë së Posaçme (SPAK) është ulur krahasuar me vitin 2021, ndërkohë që më shumë qytetarë besojnë pak ose aspak tek institucionet e lartpërmendura të drejtësisë. (shiko grafik nr. 6)

**FIGURA 6 NIVELI I BESIMIT NË INSTITUCIONET E DREJTËSISË NË SHQIPËRI NË VITET 2022 DHE 2021**

#### NIVELI I BESIMIT NË INSTITUCIONET E DREJTËSISË NË VITIN 2022 DHE 2021





Ndërmjet aktorëve joshtetërorë, komunitetet fetare konsiderohen si institucionet më të besuara nga të anketuarit: 38.49% e të pyeturve i besojnë ose besojnë plotësisht institucioneve fetare.


Partitë politike rezultojnë si institucionet më pak të besuara: 76.66% e qytetarëve kanë pak ose aspak besim. Vetëm 5.91% i besojnë ose besojnë plotësisht atyre.

Media dhe OJQ-të nuk gëzojnë gjithashtu një nivel të lartë besimi. 21.42% e të anketuarve i besojnë ose besojnë plotësisht medias dhe 40.44% i besojnë disi. Nga ana tjetër vetëm 12.81% i besojnë ose besojnë plotësisht OJQ-ve në vend, ndërkohë që një përqindje më e vogël e të anketuarve (28.40%) në krahasim me median u besojnë disi.


**FIGURA 7 NIVELI I BESIMIT TEK AKTORËT JOSHTETËRORE NË SHQIPËRI**

**SA U BESONI AKTORËVE JOSHTETËRORE TË MËPOSHTËM?**


**ORGANIZATAT JOQEVERITARE (OJQ)**




**BASHKËSIVE FETARE**



**MEDIAVE**



**PARTIVE POLITIKE**



## 4. PERCEPTIMI PUBLIK NDAJ ÇËSHTJEVE TË KORRUPSIONIT


Ky kapitull prezanton rezultatet e sondazhit në lidhje me përpjekjet e qeverisë në luftën kundër korrupsionit, besimin e qytetarëve në institucionet kundër korrupsionit si dhe reagimin e tyre në rastet e evidentimit dhe raportimit të rasteve të korrupsionit dhe meritokracinë në rekrutimin e stafit në institucionet e sigurisë dhe administratën publike.

Rezultatet tregojnë që në përgjithësi qytetarët e konsiderojnë punësimin në institucionet publike dhe ato të sigurisë jo të drejtë dhe të pabazuar në meritë. Nepotizmi konsiderohet si mënyra më e përdorur për punësim në administratë dhe institucionet e sigurisë. Gjysma e të anketuarve (50.35%) e konsiderojnë punësimin në institucionet e sigurisë të bazuar në lidhje politike dhe 40.03% mendojnë të njëjtën gjë për punësimin në administratën publike. Gjithashtu 17.53% e të anketuarve mendojnë që punësimi në institucionet e sigurisë realizohet nëpërmjet rryshfeteve dhe korrupsionit, ndërkohë që 24.86% mendojnë të njëjtën gjë për punësimin në administratën publike.


### FIGURA 8 PUNËSIMI NË INSTITUCIONET E SIGURISË DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

#### SIPAS MENDIMIT TËND, PUNONJËSIT E INSTITUCIONEVE TË SIGURISË DHE NËPUNËSIT CIVILË NË ADMINISTRATËN PUBLIKE JANË MË SHPESH TË PUNËSUAR BAZUAR NË:

##### PUNONJËSIT E INSTITUCIONEVE TË SIGURISË



##### NËPUNËSIT CIVILË NË ADMINISTRATËN PUBLIKE





#### 4. Perceptimi publik ndaj çështjeve të korrupsionit

Të pyetur në lidhje me përpjekjet e qeverisë shqiptare gjatë 12 muajve të fundit për të luftuar korrupsionin vetëm 33.54% e qytetarëve të pyetur mendojnë se ka patur një përmirësim të dukshëm/të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit.

Një përqindje e konsiderueshme (40.30%) mendojnë që situata e korrupsionit në vend ka mbetur e njëjtë, ndërkohë që 25.61% mendojnë që situata është përkeqësuar duke nënkuptuar prezencë më të madhe të korrupsionit se më parë.

**FIGURA 9** PERCEPTIMI MBI PËRPJEKJET E QEVERISË SHQIPTARE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT GJATË 12 MUAJVE TË FUNDIT



**TË LUTEM JEP NJË VLERËSIM PËR PËRPJEKJET E QEVERISË SHQIPTARE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT GJATË 12 MUAJVE TË FUNDIT:**



Qytetarët u pyetën se si do të vepronin në rast kur do të ishin dëshmitarë të një akti korruptiv. Rezultatet tregojnë që pjesa më e madhe e të anketuarve (43.69%) nuk do ta raportonin atë pasi mendojnë që kjo nuk do ta ndryshonte situatën/institucionet nuk do të reagonin, ndërkohë që 36.71% e të anketuarve do ta raportonin një rasti korruptiv tek autoritetet kompetente.

**FIGURA 10** RAPORTIMI I RASTEVE TË KORRUPSIONIT

**NË RAST SE JAM DËSHMITAR I KORRUPSIONIT, UNË:**






Qytetarët janë pyetur gjithashtu se tek cilat institucione kanë më shumë besim për të raportuar një rast korrupsioni. Media konsiderohet si kanali më i mirë për të raportuar një rast korrupsioni nga 26.76% e të anketuarve. Në lidhje me institucionet shtetërore 23.54% e të anketuarve do ta raportonin një rast korrupsioni tek Policia e Shtetit dhe 22.73% do ta raportonin atë tek SPAK, ndërkohë që vetëm 8.56% do ta raportonin tek Njësia Anti-Korrupsion pranë Ministrisë së Drejtësisë.

**FIGURA 11** NIVELI I BESIMIT TEK INSTITUCIONET PËR TË RAPORTUAR RASTE TË KORRUPSIONIT

**A MUND TË  
PËRMENDËSH  
NJË  
INSTITUCION,  
TEK I CILI DO TË  
KISHE MË SHUMË  
BESIM PËR T'IA  
RAPORTUAR  
KORRUPSIONIN?**



## 5. PËRMBYLLJA

Bazuar në të dhënat e mbledhura në këtë pyetësor, në përgjithësi niveli i besimit të qytetarëve shqiptarë tek institucionet e sigurisë dhe drejtësisë mbetet i ulët.

Forcat e Armatosura mbeten institucioni me besimin më të lartë, megjithëse asnjë institucion nuk gëzon besimin e shumicës së qytetarëve. Pavarësisht se në vitet e fundit qeveria është përpjekur të zhvillojë reforma ligjore dhe funksionale në institucionet kryesore të sigurisë si Policia e Shtetit apo Policia e Burgjeve, duket se rezultatet e këtyre reformave nuk kanë qenë mjaftueshëm efektive për të rritur besimin e qytetarëve ndaj këtyre institucioneve.

Në krahasim me sondazhin e kryer në vitin 2021, përqindja e të anketuarve të cilët kanë besim apo besim të plotë tek institucionet e Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Doganat është ulur.

Megjithëse reforma në sistemin e drejtësisë, e cila përfshiu si një nga shtyllat e saj kthimin e besimit të qytetarëve ka hyrë në vitin e 6-të të zbatimit, qytetarët shqiptarë kanë ende një nivel shumë të ulët besimi tek institucionet e drejtësisë. SPAK mbetet institucioni më i besuar nga qytetarët (edhe pse në nivele të ulëta).

Besimi tek partitë politike, i cili ka qenë përgjithësisht i ulët në anketat e tjera në vitet e mëparshme, vazhdon të mbetet i ulët. Ndërmjet aktorëve joqeveritare, media shihet nga qytetarët si një kanal i besueshëm për raportimin e korrupsionit.

Katalogimi në botim **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës - "Pjetër Bogdani"

343:303.425.6(496.5)


Hallunaj, Mirsada

Perceptimi publik ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë, si dhe çështjeve të korrupsionit në Shqipëri / Mirsada Hallunaj, Nino Strati. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2023. - 17 f. ; 24 cm.

Korrupsioni -- Testet e opinionit publik -- Shqipëri

**ISBN 978-9951-799-80-5**

Aleph [000105441]



ISBN 978-9951-799-80-5



9 789951 799805